Nr. 4435
Datë, më 13.12.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE " HAMDI BUSHATI" SHKODER

Nr. 432 Prot. Shkodër , më 10.12. 2021

Lenda: Njoftim për vënd te lirë

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër ju njofton per krijimin e vendit të lire për pozicionin:

- Mësimdhënës të praktikës profesionale me kohë të plotë Drejtimi Hoteleri-Turizëm.
(Një mësimdhënës)

1. Kritere të përgjithshme:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

2. Kritere të posaçme:
a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;

b) të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet .
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit:

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 tëkëtij udhëzimi;
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,
brenda datës 22.12.2021

DREJTOR

MERITA ZENELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HAMDI BUSHATI"
SHKODËR